

OSBE/ODIHR
MISIONI VËZHgues I ZGJEDHJEVE

REPUBLIKA E SHqipërisë
ZGJEDHJET E PUSHTETIT VENDOR
1 tetor 2000

DEKLARATË MBI GJETJET DHE PËRFUNDIMET PARAPRAKE

Tiranë, 2 Tetor 2000 - Misioni Vëzhgues i Zgjedhjeve (MVZ) i Zyrës së Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) për Zjedhjet për Qeverisjen Vendore të 1 tetorit 2000 në Republikën e Shqipërisë, nxjerr këtë deklaratë të gjetjeve dhe përfundimeve paraprake përpara vertetimit të rezultateve dhe përpara një analize të plotë të gjetjeve të monitorimit. OSBE/ODIHR-i do të publikojë një raport përfundimtar shumëplanësh mbi këto zgjedhje afërsisht rreth 1 muaj pas përfundimit të procesit.

Përfundime Paraprake

Zgjedhjet për Qeverisjen Vendore të 1 tetorit 2000 në Shqipëri shënuan një përparim domethënës drejt arritjes së standarteve për zgjedhjet demokratike të formuluara në Dokumentin e OSBE-së të Kopenhagenit të vitit 1990.

Në kontrast me rastet e mëparshme, këto zgjedhje u zhvilluan në një atmosferë të tensionuar por në një mënyrë të dukshme paqësore, me vetëm disa incidente të izoluara dhune të njoftuara gjatë fushatës dhe ditës së zgjedhjeve. Kjo pasqyroi vetëpërmbytjen që treguan partitë politike si dhe masat e rëndësishme të ndërmarra nga Qeveria për të përmirësuar rendin publik.

Në ditën e zgjedhjeve votimi u zhvillua në mënyrë të rregullt, në përgjithësi komisionet administruan procedurat në mënyrë të drejtë dhe sjellja e policisë ishte e përshtatshme. U shënuan disa parregullsi por asgjë nw dukje domethënëse që tw mund të ushtronte një efekt mbi rezultatin. Gjithashtu, numërimi i rezultateve u zhvilluan në përputhje me ligjin.

Mbas krizës së vitit 1997, autoritetet e Shqipërisë ndërmorrën një program ambicioz reformash, duke përfshirë një kuadër të ri kushtetues, legjislativ dhe administrativ, i cili çoi në një përparim të dukshëm drejt përmirësimit të strukturave të Shtetit dhe arritjes së standarteve ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Megjithatë, skena politike shqiptare mbetet mjaft e polarizuar dhe reformat u përdorën nga partitë politike kryesore për retorikën e fushatës, në një kohë kur Partia Demokratike (PD) e Opozitës hodhi poshtë shumicën e reformave.

Një Kod i ri Zgjedhor, rezultat i diskutimeve të tryezave shumë-partiake me pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtarë ofron, në përgjithësi, një bazë të shëndoshë për zgjedhjet demokratike. Megjithatë, mazhoranca parlamentare paraqiti disa dispozita kalimtare

kontradiktore në Kod, të cilat kompromentuan ekuilibrin politik të komisioneve zgjedhore.

Kuadri administrativ i këtyre zgjedhjeve ishte problematik. Caktimi i komisioneve zgjedhore në të gjitha nivelet ishte i diskutueshëm, duke shkaktuar vonesa në një kohë mjaft të kufizuar. Veprimtaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) u pengua nga mangësitë dhe pavarësia e tij e treguar në veprimtarinë e tanishme ishte e mjaftueshme. Përveç kësaj, gabimet dhe mungesat në regjistrin e ri të votuesve paraqitën një sfidë, të cilën KQZ-ja arriti t'a përballojë dhe pothuajse të gjithë votuesit arritën të votojnë në ditën e zgjedhjeve..

Për të parën herë, një spektër i gjerë i mediave u ofroi zgjedhësve një gamë të gjerë informacioni. Operatori publik ofroi pasqyrim televiziv pa pagesë në raport të barabartë për të gjithë konkurruesit dhe me zhvillimin e fushatës, një pasqyrim të drejtë në rritje. Megjithatë, mediat private vazhduan të ofronin një pasqyrim mjaft të njëanshëm dhe më pak se profesional.

Gjetjet Paraprake

Konteksti Politik

Edhe një herë Zgjedhjet e 1 tetorit vunë në dukje një polarizim të thellë të politikës shqiptare që buron nga zgjedhjet e mëparshme dhe periudhës mbas krizës së vitit 1997. Padyshim, skena politike në Shqipëri mbetet e dominuar nga të dy rivalët kryesorë politikë, Partia Socialiste (PS) e cila qeveris dhe Partia Demokratike (PD) e Opozitës. Gjatë dekadës së fundit fatet e të dyja partive kanë lëvizur në mënyrë dramatike nga një proces zgjedhor në tjetrin.

Që nga koha e krizës, autoritetet shqiptare ndërmorrën masa domethënëse për të reformuar strukturat e Shtetit dhe kuadrin zgjedhor, duke përfshirë një Kushtetutë të re (miratuar në 1998), një Kod Zgjedhor (maj 2000) dhe një regjistër kombëtar votuesish të kompjuterizuar (në verë 2000). Përveç kësaj, filloi një program ambicioz deçentralizimi për t'iu dhënë më shumë pushtet përfaqësuesve të bashkive dhe të komunave. Në përgjithësi, këta instrumenta të rinj mundësuan një përparim të madh drejt përmirësimit të strukturave shtetërore dhe standarteve ndërkombëtare për zgjedhje demokratike të formuluar në Dokumentin e OSBE-së të Kopenhagenit të vitit 1990. Megjithatë, drejtuesit e të dyja partive politike kanë shfrytëzuar këto reforma si çështje të fushatës zgjedhore, dhe themelet ligjore si dhe institucionet kryesore të shtetit mbetën mjaft të kundërshtuara nga ana PD-së. Përveç kësaj, zgjedhjet për qeverisjen vendore u konsideruan nga të dyja partitë politike si një provë për zgjedhjet parlamentare të vitit që vjen.

Kuadri Legjislativ

Zgjedhjet e qeverisjes vendore të 1 tetorit u zhvilluan nën një Kod të ri Zgjedhor, i cili u përpunua gjatë diskutimeve të tryezave shumëpartiake me mbështetjen e OSBE-së dhe me pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtarë duke përfshirë përfaqësues nga Prezenca e

OSBE-së, OSBE/ODIHR-i, Këshilli i Evropës dhe Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES). Në përgjithësi, Kodi ofron një bazë të shëndoshë për zgjedhje demokratike.

Megjithatë, disa dispozita kalimtare të Kodit, të paraqitura nga mazhoranca parlamentare në një kohë shumë të vonët në këtë proces dhe të zbatueshme vetëm për zgjedhjet e 1 tetorit, nuk janë në përputhje me dispozitat kryesore dhe rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë. Veçanërisht, u ngritën shqetësime rreth përmbajtjes dhe kryesimit të **komisioneve vendore të zgjedhjeve**, të cilat kompromentuan ekuilibrin politik të këtyre komisioneve.

Si pasojë e këtyre dispozitave kalimtare dhe një kundërshtimi të vazhdueshëm të Kushtetutës së re, duke përfshirë edhe dispozitat e KQZ-së, PD-ja e hodhi poshtë Kodin në tërësi dhe refuzoi të marrë pjesë në miratimin e tij në Kuvend, ndonëse ajo morri pjesë në shumicën e debateve të tryezave shumëpartiake.

Administrimi i Zgjedhjeve

Përbërja e komisioneve zgjedhore në nivelet qendore dhe vendore ishte burim mosmarrëveshesh midis të dy partive kryesore. Pjesërisht, si rezultat i kësaj komisionet u ngritën me vonesë, duke e rënduar sfidën me të cilin të gjithë komisionet u përballuan për të administruar këto zgjedhje komplekse brenda një kuadri kohor tepër të kufizuar.

Kushtetuta e vitit 1998 përcakton krijimin e një Komisioni Qendror të Zgjedhjeve të përhershëm dhe jo partiak. Megjithatë, emërimi i hershëm i gjashtë prej shtatë anëtarëve të KQZ-së përpara miratimit të Kodit dhe përkatësia në PS e disa anëtarëve krijuan një polemikë të madhe dhe kjo mbetet ende një shqetësim. U emëruan tre anëtarë të rinj të KQZ-së dhe polemika u pakësua mbasi komisioni miratoi një qëndrim më të ekuilibruar dhe fleksibël.

Veprimtaria e KQZ-së u pengua nga vështirësitë duke filluar me mungesën e personelit dhe të përvojës, deri në mangësi të vazhdueshme të rregullave proceduriale. Herë pas here KQZ-ja miratonte vendime në mbledhje jo-formale duke vonuar publikimin e tyre në mënyrë të panevojshme. Partitë politike, kandidatët dhe votuesit nuk informoheshin në mënyrë të mjaftueshme për këto vendime, veçanërisht në rrethe. Këto praktika patën një pasojë negative për transparencën dhe njëtrajtshmërinë e administrimit të zgjedhjeve. Komisionet vendore, veçanërisht vuanin nga një mungesë e qartë e orientimit dhe trajnimit.

Përbërja e komisioneve vendore bazohet mbi përkatësinë partiake. Dispozitat kalimtare më të debatuarat të ligjit çuan në faktin se përfaqësuesit e koalicionit qeverisës arritën të siguronin shumicën e vendeve në të gjitha komisionet vendore. Për të nxitur besimin në këtë proces KQZ-ja i udhëzoi që Kryesitë e Komisioneve Zgjedhore të Qeverisjes Vendore (KZQV) të reflektonin një ndarje 50/50 në shkallë kombëtare midis të dy partive

kryesore. KQZ-ja rekomandoi një masë të ngjashme vetëm për ndarjen e Kryesive të Komisioneve të Qendrave Votimit (KQV). Si pasojë, shumica e KQV-ve u ngritën me vonesë dhe Kryesitë nuk u ndanë në mënyrë uniforme në përputhje me rekomandimin e KQZ-së. Komisionet zgjedhore u detyruan të mbështeteshin kryesisht mbi strukturat administrative të Shtetit për ndihmë logjistike. Ky ndërveprim nuk u drejtua në mënyrë të mjaftueshme për të siguruar transparencë dhe për pasojë, nxiti akuza për ushtrim të një presioni të padrejtë.

Ndërkohë që komisionet shumëpartiake rrisnin transparencën, anëtarët partiakë të komisionit ndonjëherë edhe shfrytëzuan postet e tyre në KQV-të dhe KQV-të për të penguar administrimin zgjedhor.

Këto mangësi të administrimit zgjedhor çuan, përveç të tjerave, në boshllëqe proceduriale për rregjistrimin e kandidatëve duke ndikuar veçanërisht në mënyrë të dëmshme ndaj partive të vogla. Në disa raste, KQZ-të nuk i parashtuan dokumentacionin përkatës KQZ-së, gjë që dëmtoi seriozisht një numër të kufizuar të kandidatëve dhe të partive. KQZ-ja nuk arriti t'i trajtojë në mënyrë të efektshme ankesat.

Rregjistri i Votuesve

Filimisht, rregjistri i parë kombëtar i votuesve, i kompjuterizuar u përshëndet nga partitë kryesore si një arritje madhore. Por, mbas publikimit listat paraprake të votuesve shkaktuan një polemikë të ndezur. Një numër i konsiderueshëm gabimesh dhe mungesa e rekordeve të pasqaruara nga listat paraprake të votuesve u përdorën nga PD-ja si prova të manipulimit politik.

Në formë përgjigjeje, KQZ-ja shpalli se emrat e të gjithë rekordeve të pasqaruara të përfshira në bazën e të dhënave do të përfshihen në listat përfundimtare të votuesve dhe KQZ-ja dha udhëzimet përkatëse, duke krijuar dy rregjistra: një për votuesit e verifikuar, dhe një tjetër për rekordet e pasqaruara. Pra, të gjithë qytetarët, të cilët figuronin në njërin apo në listën tjetër kishin të drejtën të votonin. Për më tepër, KQZ-ja i udhëzoi KQV-ve të jenë fleksibël në lidhje me identifikimin e votuesve.

Përgjigja e KQZ-së ishte e efektshme sepse e zvogëloi mundësinë e mohimit të së drejtës për të votuar të votuesve dhe shmangu një krizë ditën e zgjedhjeve.

Fushata

Një total prej 2,232 kandidatësh u rregjistruan për garën e kryebashkiakëve dhe 2,360 për listat e këshilltave vendore në të 385 zonat zgjedhore. Këto të dhëna janë një provë e mëtejshme e një procesi zgjedhor konkurrues.

Fushata zgjedhore në pjesën më të madhe të saj u zhvillua në një atmosferë të qetë, ndonëse tonet e saj u shkallëzuan me afrimin e ditës së zgjedhjeve. Pati disa incidente të

izoluara të cilat ishin të lidhura me fushatën. Në kundërshtim me fushatat e mëparshme, policia në përgjithësi reagoi në mënyrën e duhur, pavarësisht nga akuzat për incidente të

izoluara kërcënimesh nga ana e policisë. Në përgjithësi, kandidatët patën mundësi që të zhvillonin fushatën e tyre në të gjitha rajonet e vendit, edhe në vende tradicionalisht të konsideruara si zonat e “palës tjetër”. Të dy forcat kryesore politike lanë në hije fushatën e partive të vogla. Gjithashtu, akordimi i fondeve publike favorizoi të dyja partitë kryesore politike.

Pati një ndryshim të qartë në retorikën e fushatës së kandidatëve vendorë dhe drejtuesëve të partive kombëtare. Ndërsa drejtuesit e partive vendore patën një qëndrim pragmatik dhe në përgjithësi respektuan njëri-tjetrin, drejtuesit e partive kombëtare vazhduan të përdorin gjuhën e urrejtjes. Megjithëse u arritën marrëveshje midis drejtuesve të partive në lidhje me etikën e fushatës në një sërë bashkish, në nivelin qendror mbizotëroi polarizimi politik.

Media

Media luajti një rol madhor në fushatën parazgjedhore si në nivelin qendror dhe në atë vendor. Për herë të parë, një spektër i gjerë i mediave u ofroi votuesve një gamë të gjerë informacioni. Megjithatë, shumë rrallë mund të quhet një media e pavarur. Në disa raste një politikë editoriale në mënyrë të theksuar në mbështetje të njëres apo partisë tjetër është qartësisht e dallueshme.

Në përputhje me Kodin Zgjedhor, Këshilli Drejtues i televizionit publik TVSh ofroi pasqyrim pa pagesë për të gjitha partitë dhe kandidatët pjesëmarrës në zgjedhje. Koha e pasqyrimin u caktua me anën e një llotarie, e cila u transmetua në televizion për të siguruar transparencën e procesit.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT), një agjenci e pavarur e ngarkuar me monitorimin dhe mbikëqyrjen e medias, veproi në një mënyrë transparente dhe të ekuilibruar duke ofruar një mekanizëm efikas për shqyrtimin e ankesave në lidhje me median. KKRT-ja e interpretoi kuadrin ligjor për mediat si një mjet për t'i detyruar operatorët televizivë privatë dhe publik të ofrojnë një pasqyrim të paanshëm gjatë fushatës. Ndërsa televizioni publik përmirësonte veprimtarinë e vet në lidhje me pasqyrimin e drejtë gjatë fushatës, mediat private i përkushtuan pjesën më të madhe të kohës së tyre të dy partive politike kryesore. Në përgjithësi, në këtë klimë politike mjaft të polarizuar, vëmendja e medias kushtuar partive të vogla ishte minimale. Përafërsisht njëzet debate televizive u zhvilluan midis kandidatëve në të gjithë vendin, gjysma e të cilëve në televizionin publik, ku morrën pjesë më shumë parti dhe gjysma tjetër në televizionet private duke u kufizuar për partitë kryesore.

Në mjaft raste, mediat i amplifikuan tonet e urrejtjes, e cila u përdor nga drejtuesit kombëtar gjatë fushatës politike. Veçanërisht, kjo vlen të theksohet në lidhje

me shtypin partiak në të cilin cilësia e informacionit të ofruar ishte e dobët dhe shpeshherë e shtrembëruar.

Dita e Zgjedhjeve dhe Numërimi i Votave

Votimi dhe numërimi i votave u zhvilluan në një mënyrë të qetë dhe të rregullt në shumicën e bashkive dhe komunave dhe nuk pati njoftime për asnjë incident të rëndë të rendit publik. Mbas vonesave në hapjen e qendrave në përgjithësi KQV-të drejtuan procedurat e votimit në mënyrë korrekte dhe me një frymë bashkëpunimi. Ishin jashtëzakonisht të pakwt votuesit që nuk gjetën emrat e tyre në listë. Në përgjithësi, sjellja e policisë ishte e përshtatshme dhe në përputhje me ligjin.

Megjithatë, u vunë re këto parregullsi ditën e zgjedhjeve:

- Në Durrës dhe në Tiranë, shpërndarja e materialit zgjedhor ishte e çrregullt dhe disa qendra votimi nuk morrën sasinë e mjaftueshme të fletëve të votimit në kohë.
- Zgjedhjet nuk u kryen në një njësi zgjedhore sepse KZQV-ja nuk arriti të shpërndajë bazën materiale të votimeve.
- Rreth 20 % e qendrave që u monitoruan shmangën përdorimin e lyerjes me bojë, ndonëse një numër fare i vogël i votuesve, të cilët u shtuan në listat shtesë tregon një mundësi jashtëzakonisht të vogël të votimit më shumë se një herë; dhe
- Votimi familjar u vu re në 56 % të qendrave që u vëzhguan.

Informacion dhe të dhëna për Misionin

MVZ-ja, me Eugenio Polizzi (Itali) si Kryetar i Misionit, u vendos në Tiranë më 25 gusht dhe shumë shpejt më vonë filloi monitorimin e procesit zgjedhor me 18 ekspertë dhe vëzhgues afat-gjatë të vendosur në kryeqytet dhe në gjashtë qendra rajonale. Për ditën e zgjedhjeve, MVZ-ja vendosi 239 vëzhgues afat-shkurtër nga 26 Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së të cilët monitoruan votimin dhe numërimin e votave në rreth 900 qendra votimi prej rreth 4,578.

MVZ-ja dëshiron të falenderojë Prezencën e OSBE-së në Shqipëri për mbështetjen e saj gjatë gjithë kohëzgjatjes së misionit, si dhe organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat për mbështetjen e tyre gjatë ditës së zgjedhjeve.

MZV-ja dëshiron të shprehë vlerësimin e saj për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe autoritete të tjera kombëtare dhe vendore për asistencën dhe bashkëpunimin e tyre gjatë punës së vëzhgimit.

Për informacion të mëtejshëm, ju lutem kontaktoni:

- Eugenio Polizzi, Kryetar i OSBE/ODIHR MZV, në Tiranë (Tel: +355-4-2 230012; Fax: +355-4-2 32522)
- Elsa Fenet, OSBE/ODIHR Këshilltare Zgjedhore, në Varshavë (Tel: +48-22-520-0600; Fax: +48-22-628-6967)

Tirana International Hotel, Rooms 604-607, Scanderbeg Square, Tirana, Albania